



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL

**PLK. D. nr. 497/22**

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT, i përbërë nga Rasim Rasimi, kryesues i Panelit, Delushe Halimi dhe Shpresa Hasaj Hyseni, anëtar të panelit, me pjesëmarrjen e Adelina Jusufi, u.d. koordinatorë e panelit për lirim me kusht, duke vendosur përkitazi me kërkesën për lirim me kusht, të parashtruar nga i dënuari K. D., për shkak të veprës penale detyrimi nga neni 328 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muaj, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PKR.nr.102/2019, të datës 19.07.2021, pas shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117, 118 par. 4 dhe 197 të Ligjit (08/ L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenet 12, 13, 14, 18, 22, 24,25 dhe 33 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 01/39) mbi Organizimin dhe Funksionimin e Panelit për Lirim me Kusht, në seancën e mbajtur me 05.10.2022, në selinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, mori këtë:

**AKTVENDIM**

**I. REFUZOHET** kërkesa për lirimin me kusht e të dënuarit K. D., i biri i P. dhe i nënës D., e lindjes K., i lindur me ..., në fshatin V., Komuna e P., ku edhe e ka vendbanimin, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**II.** Kërkesa për lirimin me kusht i refuzohet pa të drejtë rishqyrtimi.

**Arsyetim**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PKR.nr.102/2019, të datës 19.07.2021, K. D., është shpall fajtor për shkak të veprës penale detyrimi nga neni 328 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muaj.

I dënuari e ka parashtruar kërkesën për lirim me kusht përmes Institucionit të Qendrës Korrektuese ku është në vuajtje të dënimit me burg. Kërkesa për lirim me kusht është

parashtruar me datën 17.08.2022, me të cilën është kërkuar që të lirohet me kusht, me arsyetimin se gjatë vuajtjes së dënimit, me sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirimin e tij me kusht.

Paneli për lirim me kusht në seancën e mbajtur me datën 05.10.2022 pasi e shqyrtoi kërkesën e të dënuarit, dosjen e tij, raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Deklaratën-premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimimit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes gjeti se:

**Kërkesa për lirim me kusht është e pabazuar.**

Nga shkresat e çështjes, dosja e të dënuarit, rezulton se i njëjti është shpallur fajtor për shkak të veprës penale detyrimi nga neni 328 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Nga raportet e përpiluara nga Ekipi Profesionist për të dënuarin, raporti ligjor për të dënuarin vërtetohet se i dënuari lirim normal e ka me datën 18.01.2023 dhe nga llogaritja e dënimit për të dënuarin rezulton se gjer më tani i ka vuajtur 7 muaj e 17 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 3 muaj e 13 ditë. Nga raporti social për të dënuarin është konstatuar se i dënuari ka treguar sjellje të mira, pranimi të përgjegjësive, pendim për veprimet e tij dhe gatishmëri për punë dhe ndryshime. Procesi i risocializimit sipas Ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese tek i dënuari vazhdon dhe është në rrugë të drejtë.

Paneli për lirim me kusht, gjatë shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit i ka marrë parasysh të gjitha kushtet dhe kriteret për lirim me kusht për të dënuarin që parashihen në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Rregullores mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për Lirim me Kusht.

Paneli për lirim me kusht i ka vlerësuar kriteret të cilat janë të parapara me Rregulloren 01/39, mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për lirim me kusht e cila përcakton kriteret që duhet vlerësuar: 1.1 Pësia e krimit 1.2 Historia e kaluar kriminale 1.3 Përshkrimin e personit të dënuar për krimin.1.4 Qëndrimin e personit të dënuar ndaj viktimës, 1.5 Sjelljen e mirë gjatë burgimit, 1.6 Gjendjen psikiatrike dhe psikologjike të tij, 1.7 gjendjen fizike, 1.8 Historinë sociale, 1.9 planet e të dënuarit pas lirimimit, 1.10, Pranimi i kontrollit dhe ndihmesës nga Shërbimi Sprovues 1.11 Ekzistenca e një rreziku të përgjithshëm për publikun dhe 1.12 perspektiva që një person i dënuar me orgjinë të huaj ka synimin që të kthehet në shtëpi. Paneli ka vlerësuar, përveç kriterëve edhe kushtet për lirim me kusht që i parasheh Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve penale.

Paneli, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerësimit të gjitha kushteve dhe kriterëve si më lartë, me rastin e vendosjes për kërkesën e të dënuarit vlerësoi të gjitha kriteret e përcaktuara në dispozitën e nenit 14 të Rregullores nr.01/39, mbi Organizimin dhe Funkcionimin e

Panelit për Lirim me Kusht, dhe kushtet që parashihen në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe ka ardhur në përfundim se ende nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal i paraparë sipas dispozitës së nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, por edhe duke u bazuar në natyrën e rëndë të veprës penale, andaj në rastin konkret Paneli me rastin e vendosjes mori parasysh edhe nenin 14 par. 1 pikën 1.1 të Rregullores nr. 01/39, ngase pesha e krimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes se veprave tilla apo të ngjashme penale, për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua pa të drejtë rishqyrtimi.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 25 pika 1.2 e të Rregullores nr. 01/39 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT**  
**PLK. D. nr. 497/22, me datë 05.10.2022.**

U.d. Koordinatore e Panelit

Adelina Jusufi

Kryesuesi i Panelit

Rasim Rasimi

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqitet ankesë drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit.